

#### **4.25. Kapitulli 25 Shkenca dhe Kërkimi**

Ka patur progres te limituar ne politikat kërkimore dhe inovative. Agjencia e Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit (AKTI) ka forcuar kapacitetet e saj administrative dhe ka vazhduar përpjekjet për te promovuar bashkëpunimin sipas Programit te Shtate Kuadër te Bashkimit European, nëpërmjet faqes se saj zyrtare dhe aktiviteteve për rritjen e ndërgjegjësimit. Asnjë progres nuk është bere ne drejtim te integritit ne Zonën Europiane te Kërkimit dhe kontributi ne Unionin Inovativ ka qene i limituar. Niveli kombëtar i investimeve ne kërkim dhe zhvillim teknologjik është akoma shume i ulet dhe nuk ka pasur rritje qe prej vitit 2010, pavarësisht objektivave-kufijve te përcaktuar ne Strategjinë Kombëtare te Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit 2009-2015.

Ne lidhje me pjesëmarrjen e Shqipërisë ne Programin e Shtate Kuadër te Bashkimit European (FP7), numri i aplikimeve është rritur por numri i projekteve te suksesshme qe kane marre financim është akoma shume i ulet. Agjencia e Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit ka rritur përpjekjet e saj ne promovimin dhe organizimin e sesioneve trajnuese duke marre pjese ne disa evente te rrjeteve Evropiane dhe duke ndjekur ne mënyre aktive vazhdimësinë e Projektit WBC.INCO.Net, ne kuadër te FP7.AKTI ka nënshkruar Marrëveshje te Bashkëpunimit Dy-palesh me Italinë, Greqinë, Malin e Zi, Ish Republikën Jugosllave te Maqedonisë, Sllovenin dhe Turqinë.

Persë i përket integritit ne Zonën Europiane te Kërkimit (ERA), ka pasur pak progres ne implementimin e Strategjisë Kombëtare për Shkence, Teknologji dhe Inovacion. Disa masa janë marre për te forcuar burimet njerëzore, te tilla si rritja e Fondit te Ekselencës për te nxitur mobilitetin e jashtëm si edhe ngritja e Portalit Kombëtar Euraxess nga AKTI si dhe fillimi i ndërtimit te rrjetit. Nuk ka përparim ne krijimin e Qendrave te Ekselencës. Nuk ka rritje te nivelit te investimeve ne kërkim dhe asnjë veprim nuk është ndërmarre për te stimuluar investimet ne kërkim dhe inovacion nga sektori privat apo për te mbështetur partneritetin midis sektorit publik dhe atij privat.

Përveç kësaj, niveli i investimeve ne kërkim si pjese e GDP-se, është i vështirë për tu përcaktuar, kjo për shkak te mungesës se statistikave te besueshme. Financimi kombëtar për kërkim nuk është rritur por sistemi është përmirësuar ne saje te një procesi te ri përzgjedhës për projektet e financuara direkt nga departamentet. Megjithatë asnjë rishqyrtim me i detajuar nuk është aplikuar deri me tani. Agjencia Shqiptare e Zhvillimit te Investimeve (AIDA), ka filluar te stimuloje zhvillimin e inovacionit prej sipërmarrjeve duke financuar auditime teknologjike ne Sipërmarrjet e Vogla dhe te Mesme me ide inovative. Ky aksion është ne përputhje me Unionin Inovativ European.

## **Konkluzione**

Ka progres te paket ne fushën e shkencës dhe zhvillimit. Duhet bërë përpjekje te mëtejshme ne nivel kombëtar për te forcuar kapacitetet kërkimore dhe inovative dhe për te rritur konkurrencën e vendit. Niveli i investimeve ne kërkim mbetet tepër i ulët dhe burimet njerëzore kërkojnë përforsime.

Në përgjithësi përgatitjen nuk janë avancuar shumë.